REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

# PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _________2019

**PËR**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 955, DATË 7.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, pikat 1 dhe 6, 20, pika 2, e 43, të Ligjit Nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

I. Në Kreun I, bëhet kjo shtesë:

Pas pikës 4.1.4, shtohet pika 4.1.5 me këtë përmbajtje:

"4.1.5 Për familjet në nevojë, që në përbërje të tyre kanë anëtarë në moshë aktive pune që ndjekin arsimin e mesëm apo të lartë, krahas dokumentacionit të përcaktuar në pikën 4.1, paraqesin edhe vërtetimin e lëshuar nga institucioni arsimor, i cili është i detyrueshëm për t'u dorëzuar një herë brenda një viti shkollor.

II. Në Kreun II, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 gërma (a), Shtojca Nr. 1 zëvendësohet me Shtojcën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pika 9, riformulohet me këtë përmbajtje:

"dh) Refuzojnë përfshirjen në kurset e formimit profesional, për anëtarët në moshë aktive pune të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për formimin profesional;"

"e) Anëtarët në moshë aktive pune të aftë për punë që nuk rezultojnë punëkërkues të papunë pranë zyrave të punës, apo të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, me përjashtim të rasteve të familjeve që zotërojnë tokë bujqësore në pronësi/përdorim, apo familjeve që kanë anëtarë në moshë aktive pune, që ndjekin arsimin e mesëm apo të lartë, por jo më shumë se deri në moshën 25 vjeç."

3. Pas pikës 9, shtohen pikat 9/1, 9/2, dhe 9/2.1 me këtë përmbajtje:

"9/1. Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike, për një periudhë një vjeçare familjet të cilat kanë në përbërje të tyre qoftë edhe një anëtar të vetëm që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) është në moshë aktive pune dhe refuzon ofertat për punë të zyrave të punës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nxitjen e punësimit;

b) punësohen dhe ndërpresin marrëdhëniet e punës pa shkaqe të arsyeshme, me përjashtim të rasteve kur zgjidhja e kontratës bëhet nga ana e punëdhënësit".

"9/2 Zyrat e Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të kryejnë verifikime në familjet me anëtarë në moshë aktive pune dhe të hartojnë çdo muaj listën të personave në moshë aktive pune, për tia përcjellë Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

"9.2.1 Zyrat Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror ndjekin metodologjinë e daljes nga skema e ndihmës ekonomike për familjet me anëtarë në moshë aktive pune dhe mbështesin familjet me programet e shërbimit social dhe ato të aftësimit profesional dhe punësimit me strukturat përgjegjëse. Metodologjia e daljes nga skema e ndihmës ekonomike për familjet me anëtarë në moshe aktive pune përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet sociale".

4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

"Ndihma Ekonomike"

## Informacion i përgjithshëm

Ju falënderojmë që pranuat të merrni pjesë në këtë proces. Ky është një formular i ri aplikimi dhe intervista e sotme në rastin tuaj merret si përzgjedhje për përfitim të mundshëm.
Ky informacion do të jetë anonim dhe konfidencial.

"ndihma ekonomike " synon të ndihmojë familjet dhe grupe shoqërore në nevojë të cilat nuk mund të sigurojnë nevojat bazë të jetesës si dhe për te zbutur varfërinë dhe përjashtimin social.

Plotësoni një formular aplikimi për çdo familje dhe mblidhni të gjitha dokumentet e nevojshme

Ky formular aplikimi i ka pesë pjesë:

Pjesa 1a -Demografia e familjes
Pjesa 1b - Arsimimi dhe punësimi
Pjesa 2 - Banesa
Pjesa 3 – Pasuritë/asetet shtëpiake
Pjesa 4 - Mbrojtja sociale
Pjesa 5 - Të ardhurat

## Udhëzimet e përgjithshme

Përdor stilolaps të zi për të plotësuar formularin e aplikimit. Mos përdorni laps. Nëse bëni një gabim, hiqeni atë (me vizë) dhe shkruani përgjigjen e saktë pranë saj.
Nëse jeni duke përzgjedhur një përgjigje nga një listë përgjigjesh (për shembull, po ose jo) vini një kryq (x) në kutinë përkatëse.
Shënoni sasinë e të ardhurave të raportuara në lekë, dhe nëse aplikanti nuk ka të ardhura, vendosni "0" (zero) në kutinë përkatëse
Plotësoni "kodin" e përshtatshëm në kutinë e caktuar kur plotësoni informacionin në lidhje me anëtarët e familjes;
Informoni aplikantin se ndoshta familja e tij do të vizitohet për të verifikuar informacionin e dhënë në formular.
Ju duhet të informoni aplikantin se ata duhet të japin informacion të saktë dhe të plotë në mënyrë që programi të vendosë nëse atagëzojnë të drejtën që të përftojnë asistencë sociale dhe në rast se ajo jepet, ajo duhet të caktojë edhe shumën e përfitimeve.

## Aplikanti

Anëtari i familjes, i cili është përzgjedhur për të përfaqësuar familjen, duhet të jetë në moshë madhore dhe të ketë marrë numrin e identifikimit kombëtar. Numri i identifikimit kombëtar i aplikantit është thelbësore për shqyrtimin e aplikimit.

## Përkufizimi i familjes

"Familja" është një grup individësh, të lidhur në marrëdhënie bashkëshortore, si dhe në marrëdhënie prind-fëmijë, në marrëdhënie ndërmjet anëtarëve të familjes dhe në marrëdhënie te kujdestarisë mes personash që jetojnë nën të njëjtën çati.

A jeni i gatshëm të na lejoni të vizitojmë shtëpinë tuaj për pjesën e testit "Vizita në shtëpi"? Po ☐ Jo ☐

| | |
|---|---|
| Emri i administratorit social | |
| Numri i identiteti kombëtar te administratorit social | |
| Emri i personit që hedh të dhënat | |
| Vendi i intervistës | |

| | Data e intervistës | Koha e fillimit | Koha e perfundimit |
|---|---|---|---|
| Statusi i intervistës | / / | / | / |

## ...gjendja e familjes

1 ***Te dhena personale***

Mbiemri ______ Emri ______

2 *Numri i identifikimit kombëtar të aplikantit ashtu siç tregohet në kartën e identitetit* ______

3 ***Adresa***

*Ju do të merrni informacion me postë, por në disa raste, do të dëshironim të lidheshim me ju me telefon*

Kodi-postar ______ Bashki/komune ______

Rruga ______ No. ______ Block ______ Apartment ______

Rajoni ______ Qarku ______

Tel shtepise ______ I padisponueshem ______ Celulari ______ I pa disponueshem ______

4 ***Gjuha*** Në cilën gjuhë do të preferonit të merrnit informacion të mëtejshëm në lidhje me kërkesën tuaj? shqip ______

5 ***Grupi etnik*** Shqiptar ☐ Grek ☐ Roma ☐ Maqedonas ☐ Malazezë ☐ Vllahe ______ Te tjera ______

6 ***Çertifikatë familjare***

| | A | B | C | D | E | F | G | H |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | EMRAT E ANËTARËVE TË FAMILJES: BËNI NJË LISTË TË PLOTË TË TË GJITHË PERSONAVE NE FJALE PARA SE SHKONI TEK PYETJET 4-10 | Numri i identifikimit te personit (IDNP) - Tregoni N / A, nëse asnjë | Seksi:<br>M 1<br>F 2 | Data e lindjes (dite/muaj/viti) | Mosha | Marredheniet me kryefamiljarin:<br>Kryefamiljari 1<br>Bashkeshortja/Partneri 2<br>Femija/femija i adoptuar 3<br>Niper 4<br>Mbesa 5<br>Baba/mama 6<br>Moter / vella 7<br>SON, Dhender/Nuse 8<br>Kurnatë/kurnata 9<br>Gjysh/gjyshe 10<br>Vjehërr/vjehrra 11<br>Të afërm të tjerë 12<br>Jo të afërm 13 | Gjendja civile<br>1. I martuar<br>2. Divorcuar/ndarë<br>3. Jetojne se bashku<br>4. I/e ve<br>5. Beqar | A perfiton pagese te aftesise se kufizuar/pension invaliditeti ndonje nga antaret e familjes?<br>po 1<br>jo 2 |
| 1 | | | | | | | | |
| 2 | | | | | | | | |
| 3 | | | | | | | | |
| 4 | | | | | | | | |
| 5 | | | | | | | | |
| 6 | | | | | | | | |
| 7 | | | | | | | | |
| 8 | | | | | | | | |
| 9 | | | | | | | | |
| 10 | | | | | | | | |
| 11 | | | | | | | | |

# Pjesa 1b: Arsimi dhe Punësim

| | ID Code | Cili është arsimi më i lartë i arritur?<br>Asnjë 0<br>Arsimi fillor 4 vjecar 1<br>Perfunduar 8/9 vite arsim fillor 2<br>Arsim I mesëm I pergjithshem 3<br>Arsim Profesional 2-3 vjet 4<br>Arsim profesional 4-5 vjet 5<br>Perfunduar universitetin ne Shqiperi 6<br>Perfunduar universitetin jashte Shqiperise 7<br>Pas universitar ne Shqiperi 8<br>Pas universitar jashte Shqiperise 9 | PYET TË GJITHË NE FAMILJE 16 VJEC E LARTE<br>A jeni duke ndjekur arsimin e mesëm apo të lartë? Niveli bachelor? Niveli Master? Doktoraturë ? | A keni punuar në 4 javët e fundit? Përfshirë punën e papaguar në një fermë apo biznes familjar apo edhe disa orë punë si e rastësishme?<br>1= Po<br>2= Jo | Nëse ju nuk keni punuar, a keni pasur një punë nga e cila keni munguar përkohësisht?<br>1= Po<br>2= Jo | Ne kete pune, ju jeni...<br>1 = Një punonjës i dikujt i cili nuk është anëtar i familjes<br>2 = punëtor me pagesë në një fermë familjare apo biznes tjeter<br>3=Punëdhënes<br>4 = Punëtor me llogari më vete (i vetë-<br>5 = punëtor i papaguar në fermë/biznes familjare<br>6=te tjera___ | A keni të drejtë te perfitoni nga skema e sigurimeve shoqërore në këtë punë?<br>1= Po<br>2= Jo | Sa ishte pagesa juaj e fundit apo fitimet NETO? (Nëse i intervistuari ende nuk është paguar, PYETe: Çfarë pagese presin) Cilën periudhë kohore mbulon kjo pagese / apo fitim?<br>Njesia ne kohe<br>Muaj 1<br>15 dite 2<br>Javore 3<br>Ditore 4<br>LEKE | Njesia kohore | Sa është pagesa/fitimi juaj i zakonshem NETO? Çfarë periudhe kohore mbulon kjo pagese? (merr parasysh kohën e 12 muajve të fundit, nëse ju keni filluar punë më pak se 12 muaj më parë, merr në konsideratë mesataren qysh nga fillimi)<br>Njesia kohore<br>Muaj 1<br>15 Dite 2<br>Javore 3<br>Dite 4<br>LEKE | Njesia Kohore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | | | | | | | | | |
| 2 | | | | | | | | | | | |
| 3 | | | | | | | | | | | |
| 4 | | | | | | | | | | | |
| 5 | | | | | | | | | | | |
| 6 | | | | | | | | | | | |
| 7 | | | | | | | | | | | |
| 8 | | | | | | | | | | | |
| 9 | | | | | | | | | | | |
| 10 | | | | | | | | | | | |
| 11 | | | | | | | | | | | |

## Pjesa 2: Banesa, Uje/drita/gaz dhe mallra te qendrueshem

7 TIPI I BANSES

| | |
|---|---|
| SHTEPI PER NJE FAMILJE | 1 |
| BANESA ESHTE NJE NDERTESE ME 15 APARTAMENTE | 2 |
| BANESA ESHTE NJE NDERTESE ME ME SHUME SE 15 APARTAMENTE | 3 |
| TE TJERA (SPECIFIKO)__________ | 4 |

8 Numi I dhomave qe ka familja :

(perjashto kuzhinen, ballkonin, korridoret dhe banjat)

9 CILA ESHTE GJENDJA E NJESISE SE BANIMIT?

| | |
|---|---|
| GJENDJE SHUME TE MIRE | 1 |
| E PERSHTATSHME PER JETESE | 2 |
| E PAPERSHTATSHME PER JETESE | 3 |
| NE RIKONSTRUKSION | 4 |

10 Cfare tip banjoje ka banesa juaj?

| | |
|---|---|
| WC BRENDA SHTEPISE | 1 |
| 2 OSE ME SHUME WC BRENDA SHTEPISE | 2 |
| WC JASHTE ME TUBACIONE | 3 |
| WC JASHTE, PA TUBACION | 4 |
| TE TJERA (SPECIFIKO) __________ | 5 |

11 A ka banesa juaj te meposhtmet?

(sheno kutine nese "PO")

| | |
|---|---|
| KUZHINE TE NDARE | |
| DUSH/VASKE TE NDARE | |
| BALLKON OSE TARRACE | |
| ANEKS GATIMI | |
| PAPAFINGO | |
| GARAZH | |
| ASHENSOR | |

12 Cili eshte statusi I pronesise se kesaj ndertese?

| | |
|---|---|
| PRONAR | 1 |
| PRONAR ME NJE HUA HIPOTEKARE PER NDERTESEN | 2 |
| E MARRE ME QERA NGA NJE INDIVID PRIVAT | 3 |
| E DHENE ME QERA NGA SHTETI | 4 |
| JETOJ FALAS/PA PAGESE | 5 |
| TE TJERA (SPECIFIKO__________) | 6 |

13 Cila eshte distanca e baneses nga..............me I afert?
(Me kembe, vajtje/ose ardhje)

| | MINUTA |
|---|---|
| STACION AUTOBUSI/ FUGONI | |
| SHKOLLE FILLORE | |
| AMBULANCE/DOKTOR | |

14 Cili eshte burimi kryesor I ujit te perdorur ne kete familje?

| | |
|---|---|
| UJE I RRJEDHSHEM BRENDA BANESES | 1 |
| UJE I RRJEDHSHEM JASHTE BANESES | 2 |
| ÇEZEM PUBLIKE | 3 |
| AUTOBOT ME UJE | 4 |
| BURIM OSE PUS | 5 |
| LUM, LIQEN, PELLG UJOR APO DICKA E TILLE | 6 |
| TE TJERA (SPECIFIKO)__________ | 7 |

## PJESA 3: Asetet familjare

| 18. Për çdo artikull të listuar më poshtë, ju lutem tregoni nëse familja juaj i zotëron ato apo jo? Lexoni te gjithë listën e artikujve | | A ka familja ARTIKULL |
|---|---|---|
| ARTIKULL | KODI | 1 = PO<br>2 = NO |
| TV ME NGJYRA | 101 | |
| TV PA NGJYRA | 102 | |
| Vidio/DVD player | 103 | |
| Magnetofon/CD player | 104 | |
| Kamera, video kamera | 105 | |
| Frigorifer | 106 | |
| Frigorifer ftohës (ngrires) | 107 | |
| Makinë larëse | 108 | |
| Pjatalarëse | 109 | |
| Sobë me gaz/energji elektrike | 110 | |
| Sobe me vajguri | 111 | |
| Sobe me dru zjarri | 112 | |
| Mikrovalë | 125 | |
| Kalorifer | 113 | |
| Gjenerator | 114 | |
| Makinë qepëse/thurrëse | 115 | |
| Kondicioner | 116 | |
| Bolier | 117 | |
| Komputer | 118 | |
| Aparat marrës satelitor/ aparat marres kabllor | 119 | |
| Biçikletë | 120 | |
| Motoçikletë/ Motor me kubik të vogël | 121 | |
| Makinë/veturë | 122 | |
| Kamion | 123 | |
| Makinë Dumdum | 124 | |

| 19. A zoteron toke familja juaj? | | |
|---|---|---|
| Po | 1 | |
| Jo | 2 | |

| 20. Cila eshte siperfaqja e tokes? | |
|---|---|
| Metra katrorë | |

| 21. A ka dikush në familjen tuaj ndonjë gjë të gjallë, shpezë, zgjua bletësh, ose që angazhohet në akuakulturë? | |
|---|---|
| Po | 1 |
| JO | 2 |

| 20. Sa kafshë, shpezë, zgjua bletesh, apo peshk te kultivuar ka familja juaj aktualisht? | |
|---|---|
| TIPI | NUMRI |
| Lopë | |
| Derra | |
| Dele/dhi | |
| Shpezë | |
| Kuaj | |
| Gomar, Mushkë | |
| Dem | |
| Zgjua bletësh | |
| Lepuj | |
| Peshk (akuakulture) | |

## Pjesa 4: Mbrojtja Sociale

| | BURIMI | 22A<br>Në 12 muajt e fundit, a ka marrë ndonjë anëtar i familjes tuaj ndonjë pagesë nga burimet e mëposhtme? BENI PYETJE PER SECILIN BURIMI PARA SE TË VAZHDONI<br>PO 1<br>JO 2<br>>>BURIMI TJETER | 22B<br>Cila ishte shuma e pageses se familjes suaj e fundit?<br>LEKE | 22C<br>Cili eshte numri i muajve qe u referohet kjo pagese?<br>MUAJ |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ndihma Ekonomike | | | |
| 2 | Pagesa per aftesine e kufizuar | | | |
| 3 | Pension pleqerie - Urban | | | |
| 4 | Pension pleqerie -Rural | | | |
| 5 | Pension suplementar | | | |
| 6 | Pension invaliditeti - Urban | | | |
| 7 | Pension invaliditeti- Rural | | | |
| 8 | Pension per merita te veçanta | | | |
| 9 | Pension familjar - Urban | | | |
| 10 | Pension familjar - Rural | | | |
| 11 | Pagese papunesie | | | |
| 12 | Perfitime per veterane te luftes | | | |
| 13 | Pagesa per barrelindje (perfshin pagesat e marra gjate lejes se lindjes) | | | |
| 14 | Kujdesi social/ sherbimet per te moshuarit dhe per personat me aftesi te kufizuar | | | |
| 15 | Pagesa te lejes se semundjes (1-6 muaj) | | | |
| 16 | Te tjera_____(specifiko) | | | |

## 5-Te ardhura te tjera

| | BURIMI I TE ARDHURAVE | 23 Në 12 muajt e fundit a keni marre pagesë nga burimet e mëposhtme (para ne dore apo forme tjeter pagese) ju apo ndonjë anetar tjeter i familjes tuaj? PO 1 / JO 2 | 24 Cila eshte shuma ne total qe ka marre familja juaj në 12 muajt e fundit nga [BURIMI], përfshirë vlerën e ndonjë dhurate ose pagesë në formë mallrash? LEKE |
|---|---|---|---|
| 1 | Perfitime nga mbrojtja sociale (All SP) | | |
| | **Remitanca/ dergesa ne te holla/ dhurata** | | |
| 2 | Remitanca/ dhurata nga te aferm jashte shtetit | | |
| 3 | Dhurata nga te aferm ne Shqiperi | | |
| 4 | Dhurata nga te aferm te tjere (perfshire dhurata per nje cermoni) | | |
| 5 | Dhurata/ asistence nga institucione | | |
| | **Te ardhura nga qeratë** | | |
| 6 | Qera nga toka /por jo toke bujqesore | | |
| 7 | Qera nga apartamentet/shtepia | | |
| 8 | Qera nga dyqani, dyqanet etj | | |
| 9 | Qera nga makina, kamioni apo automjete te tjera | | |
| | **Te ardhura nga shitjet e aseteve** | | |
| 10 | Shitje e prones se patundshme shtepi, toke...) | | |
| 11 | Shitje e mallrave te qendrueshme te familjes | | |
| 12 | Shitje e aseteve te tjera | | |
| | **Te ardhura te tjera** | | |
| 13 | Nga ndonje trashegimi | | |
| 14 | Fitime nga lotarite apo bixhozi/kumari | | |
| 15 | Te ardhura te tjera(_____) | | |
| | **TE ARDHURA BUJQESORE** | | |
| 16 | Prodhime bujqesore te shitura /bimë bujqesore | | |
| 17 | Produkte te shitura bujqesore s (mjaltë, pije alkolike (raki, vere), ushqim te perpunuar etj | | |
| 18 | Gjë e gjallë e shitur /shtazore | | |
| 19 | Nen-produkte shtazore te shitura (veze, qumesht, djath, lesh, lekurë bagetish, etj.) | | |
| 20 | Te ardhura ne lekë ne dorë ose kontribut ne natyrë nga kooperfativat bujqesore apo shoqata te tilla | | |

25 CILAT JANE TE ARDHURAT NETO MUJORE NE TOTAL TE FAMILJES
në këtë moment (shuma ne total e të ardhurave të anëtarëve të familjes nga pagat / rrogat, mbrojtja sociale, pensionet, Asistenca)

26 **CILAT JANE SHPENZIMET TOTALE MUJORE TE FAMILJES**

27 A ka diçka tjeter qe deshironi te me thoni?

28 **Emrin e kryefamiljarit/bashkeshortes qe do te administroj shumen e ndihmes**

... te personit qe intervistonet (veshje, këpucë ..)

1. Ne gjendje shume te keqe
2. Ne gjendje te keqe
3. Ne gjendje mesatare
4. Ne gjendje normale
5. Ne gjendje te mire

**2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes ekonomike të familjes**

Bazuar në eksperiencen tuaj të vlerësimit të familjeve të tjera dhe në krahasim me fqinjët, ku do ta vendosnit familjen sipas nje shkalle standarte jetese nga 1-5, ku 1 eshte shume e varfer, dhe 5 –e pasur mbi mesataren

1. Jashtezakonisht e varfer
2. Shume e varfer
3. E varfer
4. Pasuri mesatare
5. E pasur mbi mestaren

**Çfarë karakteristika shihni ju ne vlerësimin e situatës se mësipërme ekonomike për këtë familje?**

**4. Vlerësimi i besueshmërisë së informacionit të dhënë:**

Cili është vlerësimi juaj per sinqeritetin e aplikantit ne dhenien e informacionit ?

1. E vertete (Po 1 Jo 2)

2. Nese jo cili prej informacioneve te meposhtem mendoni se mund te ri-kontrollohet (sheno ne secilen kuti)

2.1 Fsheh te ardhurat
2.2 Fsheh numrin e gjësë së gjallë
2.3 Fsheh hapesiren e jeteses /dhoma
2.4 Fsheh asete te tjera
2.5 Fsheh banesen
2.6 Paraqet ndryshe informacionin individual per anetaret e familjes
2.7 Fsheh qe ka femije ne moshe madhore

**5. Ndonje koment tjeter, ju lutem shenoni me poshte:**

# RELACION

## PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TE MINISTRAVE

## PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 955, DATË 7.12.2016 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE", TË NDRYSHUAR

### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektakt ka për qëllim të shmangë abuzivitetin në skemën e ndihmës ekonomike me qëllim që ndihma ekonomike të përfitohet nga kategoritë më në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara social ekonomike, si dhe të sigurojë integrimin e tyre në jetën shoqërore.

Objektivat që synohen të arrihen kanë të bëjnë me: (i) nxitjen e punësimit të anëtarëve të familjeve përfituese të cilët janë në moshë aktive pune; (ii) mosrefuzimin e ofertave të përshtatshme të punës nga zyrat e punës; (iii) forcimin e masave shtrënguese në rastet e refuzimit apo largimit nga puna, me synimin për të shmangur sigurimin e të ardhurave në mënyrë alternative (informale); (iv) mospenalizimin e familjeve me fëmijë në moshë aktive pune që ndjekin arsimin e mesëm apo të lartë për shkak të mosparaqitjes pranë zyrave të punës për të kërkuar punësim.

### II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky akt është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave, Kapitulli 3 "Shërbimet Publike", seksioni 3.3 "Shëndetësia dhe Kujdesi Social" dhe hartohet brenda programit analitik të akteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2019.

### III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përparësitë e projektaktit. Ky projektakt shmang abuzivitetin në skemën e ndihmës ekonomike duke nxitur qytetarët të përfshihen në programe formimi profesional për të marrë një profesion, përfshirjen në programe këshillimi për punësim, si edhe punësimin e tyre përmes ofertave të punës që disponojnë zyrat e punës.

Problematikë e pritshme mund të jetë pakënaqësia e familjeve aplikuese dhe përfituese për shkak të forcimit të penaliteteve për refuzimin e punësimit apo ndërprerjen pa shkaqe të arsyeshme të marrëdhënieve të punës. Megjithatë, nga ana tjetër pritet që ky projektakt të ketë edhe efekte pozitive lidhur me: nxitjen e punësimit; shmangien e sigurimit të të ardhurave në mënyrë

alternative; shmangien e punës informale; mospenalizimin e familjeve me fëmijë në moshë aktive pune që ndjekin arsimin e mesëm apo të lartë; dhe integrimin e familjeve në nevojë në jetën shoqërore.

## IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektakt hartohet në mbështetje të nenit nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, pikat 1 dhe 6, 20, pika 2, e 43, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar.

## V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS

Projektakti nuk ka përputhshmëri me *Acquis* të Bashkimit Evropian.

## VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektakti është ndarë në dy krerë.

Në pikën I të projektaktit parashikohen ndryshime në Kreun I të aktit ndryshues që kanë të bëjnë me shtimin e një pike në paraqitjen e dokumentacionit të familjeve përfituese ku kërkohet që për anëtarët e familjes në moshë aktive pune që ndjekin arsimin e mesëm apo të lartë, të paraqitet një herë brenda një viti shkollor vërtetimi i lëshuar nga institucioni arsimor, që personi në fjalë ndjek arsimin e mesëm/lartë. Për arsimin e mesëm i referohemi grup-moshës 16-18 vjeç, e cila sipas legjislacionit në fuqi për punësimin i lejohet të punojë.

Në pikën II të projektaktit parashikohet zëvendësimi i formularit të aplikimit i cili përfshin edhe rastet e studentëve për mospenalizim të familjes për përjashtim nga skema e ndihmës ekonomike.

Po ashtu riformulimi i gërmës (dh), të pikës 9, të kreut II të aktit ndryshues, i cili parashikon mosrefuzimin e përfshirjes në kurset e formimit profesional, për anëtarët në moshë aktive pune të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, me qëllim që të mos përjashtohen nga ndihma ekonomike për 6 muaj. Po ashtu, rishikohet edhe gërma (e) ku në kategoritë që përjashtohen nga detyrimi i paraqitjes pranë zyrave të punës përfshihen studentët që ndjekin arsimin e mesëm apo të lartë.

Projektakti parashikon shtimin e pikave 9/1, 9/2 dhe 9/2.1 në aktin ndryshues duke parashikuar përjashtimin nga përfitimi i ndihmës ekonomike, për një periudhë 1 vjeçare, të familjeve që kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm në moshë aktive pune që refuzon ofertat e përshtatshme për punë të zyrave të punës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nxitjen e punësimit.

Parashikohet që për familjet, anëtarët e të cilave punësohen dhe ndërpresin marrëdhëniet e punës pa shkaqe të arsyeshme, të mos kenë të drejtë riaplikimi për ndihmë ekonomike për një periudhë një vjeçare, me përjashtim të rasteve kur zgjidhja e kontratës bëhet nga ana e punëdhënësit.

Gjithashtu përcaktohet shtimi i pikave 9.2 dhe 9/2/1 sipas të cilave Zyrat Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror kryejnë verifikime në familjet me anëtarë në moshë aktive pune dhe hartojnë çdo muaj listën të personave në moshë aktive pune, për tia përcjellë Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Në pikën 9.2.1 përcaktohet se Zyrat Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror ndjekin metodologjinë e daljes nga skema e ndihmës ekonomike për familjet me anëtarë në moshë aktive pune dhe mbështesin familjet me programet e shërbimit social dhe ato të aftësimit profesional dhe punësimit me strukturat përgjegjëse. Ministri përgjegjës për çështjet sociale përcakton me urdhër metodologjinë e daljes nga skema e ndihmës ekonomike për familjet me anëtarë në moshe aktive pune.

Në pikën 4 përcaktohen institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi.

## VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektakti janë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetqeverisjes vendore.

## VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektakt dërgohet për konsultim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore dhe Vetëqeverisjes Vendore.

Projektakti dërgohet për standardizim të formularit të aplikimit pranë Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

## IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektakti nuk ka efekte financiare.

**PROPOZUESI**

**Ogerta MANASTIRLIU**

**MINISTËR**